

Data 21.09.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Ndertim i sistemit elektronik te taksave dhe tarifave

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 083 333(dy milion e tetëdhjetë e tri mijë e treqind e tridhjetë e tre) lek pa tvsh dhe 2 500 000 (dy milion e pesëqindmijë) lek me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 - 2024 - 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2023 - 2024 - 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit. Shënim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të dorëzojë:

Shërbime të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të

kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara (sipas shtojces nr.9).

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar të të paktën 7 (shtatë) personave për periudhën e fundit objekt deklarimi, vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën përkatëse;

-Listë pagesat e punonjësve për periudhën përkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (në formë elektronike);

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve të kerkuar i korrespondon numrit të specilistëve të kerkuar në pikën 2.3.4 të cilët janë kerkuar në përputhje me termet e references.

Operatorët ekonomik duhet të disponojnë certifikatat:

2.3.3.Operatorët ekonomik duhet të disponojnë certifikatat:

S/SH/EN/ISO 9001: 2015 “Për menaxhimin e cilësive”

S/SH/EN/ISO 27001: 2022 “Sistemi I menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Certifikatat duhet të jenë në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen dhe të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Në rast bashkimi operatorësh, këto certifikata duhet të ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve sipas marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Certifikata 9001:2015 është një dokument që provon se operatori operon konform standarteve të njohura nga Republika e Shqipërisë në cilësinë e produktit që ofron.

Certifikata 27001:2022 është një dokument që provon se operatori ndjek standartet nderkombetare të njohura nga Republika e Shqipërisë në fushën e sigurisë së informacionit që është edhe një nga elementet kryesore në shërbimin që po prokuron |AK.

2.3.4. OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit objekt deklarimi, jo më pak se:

- a. Punonjes të diplomuar për shkencë kompjuterike 1 (një)
- b. Punonjes të diplomuar inxhinier softuerik 1 (një)
- c. Punonjes të diplomuar për teknologji informacioni dhe komunikimi 1 (një)
- d. Punonjes të certifikuar për “Windows defender” 1 (një)
- e. Punonjes të certifikuar për “Administrim databazë” 1 (një)
- f. Punonjes të certifikuar për “Menaxhim projekte” 1 (një)
- g. Punonjes kontabilist 1 (një)

Për punonjësit (d,e,f) duhet të paraqitet kontratat e punës, cv, dokumenti i certifikuesit kurse për pjesën tjetër të stafit duhet të paraqitet diploma, cv dhe kontratat përkatëse të punës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Punonjësit e kërkuar më sipër janë në përputhje me termat e referencës duke pasur parasysh që shërbimi i kërkuar nga AK është një shërbim specifik në fushën e teknologjisë së informacionit dhe prodhimit të sistemeve softuerike ku janë të domosdoshëm konkretisht :

- b. Punonjes të diplomuar inxhinier softuerik 1 (një)
- c. Punonjes të diplomuar për teknologji informacioni dhe komunikimi 1 (një)

d. Punonjes të certifikuar për “Windows defender” 1 (nje)

e. Punonjes të certifikuar për “Administrim databaze” 1 (nje)

a. Punonjes të diplomuar per shkenca kompjuterike 1 (nje) eshte kerkuar pasi nevojitet gjate instalimit fizik ne pajisjet kompjuterike te Ak ndersa f. Punonjes të certifikuar për “Menaxhim projektesh” 1 (nje)

g. Punonjes kontabilist 1 (nje) nevojiten per trajnimin e perdoruesve.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument të vlefshëm lëshuar nga AKSHI për prodhim të software fiskal.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Operatori duhet të deshmojë se është i pershtatshëm dhe i licensuar për të ofruar produktin e kerkuar nga AK.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr pësupër të fillojë implementimin e programit brenda dy ditësh nga nënshkrimi i kontratës dhe realizimin dhe instalimin e plotë të sistemit brenda afatit 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, (pika 6), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kjo deklaratë siguron AK që OE do të fillojë menjëherë instalimin dhe do të respektojë afatin total prej 30 ditësh.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr pësupër të mirëmbajë sistemin për të paktën 1 vit nga instalimi perfundimtar i tij.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, (pika 6), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kjo deklaratë siguron AK që OE ofron mirëmbajtjen e nevojshme për një periudhë 1 vjeçare e cila është e domosdoshme edhe për funksionimin normal të sistemit por edhe për garancinë e produktit të rregullt.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklarohet se merr pjesë për të trajnuar përdoruesit e sistemit deri në funksionimin normal të tij por jo më pak se 5 ditë.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, (pika 6), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kjo deklaratë siguron AK që OE do të ofrojë trajnimin e duhur për përdoruesit dhe procesi i cili është i domosdoshëm për efikasitetin e këtij programi dhe funksionimin e tij në mënyrë të rregullt.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklarohet se merr pjesë që gjatë mirëmbajtjes së sistemit për çdo problematikë të konstatuar nga përdoruesit të kthejë një përgjigje zyrtare AK në lidhje me problemin në një interval kohor prej jo më shumë se 10 minuta.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, (pika 6), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në rast është e nevojshme që problemet që hasen gjatë përdorimit të sistemit të adresohen tek OE që e mirëmban atë dhe njëkohësisht duhet që të merret edhe një përgjigje. Lidhje me problemin dhe kjo duhet të jetë sa më e shpejtë prandaj AK vlerëson të domosdoshme që OE të deklarojë se e merr pjesë për një gjë të tillë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termit e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

